



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.42, datë 28.09.2007

**“PËR FINANCIMIN E PJESSHËM TË PROJEKTIT “PILOTIMI I SKEMËS SË NDIHMËS
SË RE EKONOMIKE, TË SHOQËRUAR ME PUNË NË KOMUNITET NË NJËSITË
BASHKIAKE NR.1, 5, 6, 8, 9, 11”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000, “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika 3/II, gërma “c”, Ligjit Nr.9355, dt.10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore, V.K.M. Nr.787, dt.14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, V.K.M. Nr.557, dt.16.08.2006 “Për disa ndryshime në V.K.M. Nr.167, dt.29.03.2006 “Për disa çështje në zbatim të Ligjit Nr.7703, dt.11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në Ligjin Nr.7870, dt.13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe V.K.B. Nr.23, dt 30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007” me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë projektin “Pilotimi i skemës së re të ndihmës ekonomike të shoqëruar me punë në komunitet në Njësitë Bashkiake Nr.1,5,6,8,9,11”, me shumën totale prej 21.396.466 lekë.
2. Efektet financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të mbulohen nga fondet e ndihmës ekonomike të Njësive Bashkiake në shumën prej 4.509.060 lekë, si dhe nga fondet e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës në shumën prej 16.887.406 lekë.
3. Totali në shumën 16.887.406 lekë, do të përballohet, duke pakësuar këtë shumë nga fondi i miratuar me V.K.B. Nr.23, dt.30.04.2007 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të vitit 2006 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007” në zërin “Punë në komunitet” (artikulli 604), fond i cili do t’u delegohet Njësive Bashkiake duke shtuar buxhetet e tyre për vitin 2007, si më poshtë:

▪ Njësia Bashkiake Nr.1 , në total:	3.813.217 lekë
“Paga” (artikulli 600)	2.992.020 lekë
“Sigurime Shoqërore” (artikulli 601)	821.197 lekë

▪ Njësia Bashkiake Nr.5 , në total:	2.362.448 lekë
“paga” (artikulli 600)	1.849.200 lekë
“Sigurime Shoqërore (artikulli 601)	513.248 lekë
▪ Njësia Bashkiake Nr.6 , në total:	2.428.448 lekë
“Paga” (artikulli 600)	1.915.200 lekë
“Sigurime Shoqërore” (artikulli 601)	513.248 lekë
▪ Njësia Bashkiake Nr.8 , në total:	1.038.424 lekë
“Paga” (artikulli 600)	781.800 lekë
“Sigurime Shoqërore” (artikulli 601)	256.624 lekë
▪ Njësia Bashkiake Nr.9 , në total:	1.228.264 lekë
“Paga” (artikulli 600)	971.640 lekë
“Sigurime Shoqërore (artikulli 601)	256.624 lekë
▪ Njësia Bashkiake Nr.11 , në total:	6.016.604 lekë
“Paga” (artikulli 600)	4.562.400 lekë
“Sigurime Shoqërore (artikulli 601)	1.454.204 lekë

4. Ngarkohen Njësitë Bashkiake Nr.1,5,6,8,9,11, të bëjnë rishpërndarjen e fondeve të mbetura për nëngrupet e familjeve përfituese të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike, nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Bashkiakë të Njësive të tyre.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Përkujdesit Social, Drejtoria e Buxhetit & Administrimit Financiar, Drejtoria e Financës, si dhe Njësitë Bashkiake Nr.1,5,6,8,9,11.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R